



Funded by
the European Union



NJOFTIM PËR PUNËSIM

Psikolog, për të ofruar shërbime mbështetëse sociale të integruara për fëmijën dhe familjen në Bashkinë Kurbin

Projekti: SAFE CENTRE: Support services for vulnerable children in Mamurras

Titulli i pozicionit: Psikolog, për të ofruar shërbime mbështetëse sociale të integruara për fëmijën dhe familjen në Bashkinë Kurbin

Vendodhja: Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin

Lloji i kontratës: Kontratë punësimi me kohë të pjesshme (20 orë/javë)

Kohëzgjatja: 9 muaj (Maj 2025-Janar 2026)

1. HISTORIK

1.1 Autoriteti Kontraktues

Shoqata "Together for Life" (TFL) është një organizatë jopolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse, e themeluar në fund të vitit 2009 si një iniciativë e një grupi gazetarësh me reputacion, si organizatë me anëtarësi. TFL ka ndërmarrë një sërë projektesh dhe aktivitësh inovatore dhe të suksesshme. Ajo ka fituar reputacion si organizata e parë dhe më e shquar që merret me të drejtat shëndetësore në vend; si dhe ka zgjeruar aktivitetin e saj për të promovuar debatin për ndërtimin e shoqërisë civile dhe një kulturë të mirëqeverisjes dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri; me fokus në komunitetet vulnerabël; komunitetet që jetojnë në zona të largëta ose më pak të favorizuara ekonomikisht; gratë dhe të rinjtë. Ajo u themelua mbi vlerat e transparencës, qasjes pjesëmarrëse; punë në ekip; përkushtim dhe efikasitet të bazuar në parimet e zhvillimit dhe koordinimit të të gjitha palëve të interesuara në procesin e zhvillimit. Një nga pikat e forta të saj kryesore, është ekspertiza e saj në aktivitetet për të nxitur debatin mbi rëndësinë e angazhimit qytetar, për të promovuar të drejtat e pacientëve në Shqipëri, me fokus në komunitetet e cënueshme, fëmijët, të rinjtë dhe gratë.

1.2 Rreth projektit

Projekti QENDËR E SIGURT: Shërbime mbështetëse për fëmijët vulnerabël në Mamurras, po zbatohet në Bashkinë Kurbin, Njësia Administrative në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania.





Funded by
the European Union



Ky projekt duket si një hap i rëndësishëm për të adresuar boshllëqet në shërbimet sociale për fëmijët vulnerabël në Njësinë Administrative Mamurras. Projekti i propozuar nga shoqata Together for Life në bashkëpunim me Bashkinë e Kurbinit, fokusohet në nevojën kritike për të mbështetur fëmijët nga 6 deri në 12 vjeç, veçanërisht ata që vijnë nga familje me probleme social ekonomike, nga familjet me kryefamiljare femra, fëmijë që janë viktima të dhunës në familje, etj.

Duke iu referuar të dhënave nga Plani Social Lokal i Bashkisë Kurbin, me 1,184 fëmijë të identifikuar si të rrezikuar ose në nevojë për mbështetje, ky projekt mund të ndihmojë në përmbushjen e një kërkesë të madhe për kujdes dhe ndërhyrje. Krijimi i QENDRËS SË SIGURT si një burim lokal do të jetë thelbësor, sidomos pasi disa njësiti administrative si Mamurrasi aktualisht nuk kanë mbulim në shërbime sociale.

Pasi të krijohet QENDRA E SIGURT, ajo mund të ofrojë shërbime mbështetëse sociale, të integruara, qoftë mbështetje shkollore, kujdes psikosocial, aktivitete argëtuese dhe informuese e edukuese, duke siguruar që këta fëmijë dhe familjet e tyre, të cilët janë më të rrezikuarit, të marrin ndihmën që ju nevojitet. Gjithashtu, kalimi i pronësisë së qendrës tek bashkia do të sigurojë që mbështetja të jetë e qëndrueshme dhe të vazhdojë edhe pas fazës fillestare të projektit.

2. PËRSHKRIMI I POZICIONIT

Together for Life (TFL) po kërkon të kontraktojë një **Psikolog me kohë të pjesshme** për të ofruar shërbime të integruara psiko-sociale në mbështetje të fëmijëve që vijnë nga familje vulnerabël. Këto shërbime do të ofrohen pranë qendrës ditore SAFE Center që do të ngrihet pranë Njësisë Administrative Mamurras, në Bashkinë Kurbin.

2.1 Përgjegjësitë specifike dhe rezultatet e pritura

Përgjegjësitë dhe rezultatet e pritura nga punonjësi social janë si më poshtë:

- Realizon menaxhimin e rasteve duke shfrytëzuar burimet ekzistuese në komunitet dhe identifikon të gjitha shërbimet që ofrohen aty, duke siguruar ndërhyrje të efektshme për përfituesin, në përputhje me procedurat standardizuara të metodologjisë së menaxhimit të rastit.
- Përgatit dhe mirëmban dokumentacionin në përputhje me procedurat financiare dhe administrative të projektit, duke siguruar cilësi dhe saktësi në të gjitha proceset.
-





Funded by
the European Union



unicef 
for every child

World Vision 

- Bashkërendon dhe ndihmon në zbatimin e procedurave të menaxhimit të rastit, duke raportuar çdo informacion të rëndësishëm përpara koordinatorit të projektit dhe PMF-së.
- Aktivizohet në terren, realizon vizita në familje dhe bashkëpunon ngushtë me stafin e qendrës, NJMF dhe aktorët mbështetës të komunitetit për të siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë dhe në kohë për individët dhe familjet në nevojë.
- Planifikon dhe organizon aktivitete që janë të lidhura me temat e projektit dhe kalendarin e punës, për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të parashikuara, në qendër dhe jashtë saj.
- Bën vlerësime psikologjike, duke përdorur instrumenta të standartizuara në lidhje me problematika të zhvillimit për fëmijët.
- Bën këshillime dhe mbështetje psikologjike për fëmijët dhe të rriturit që janë referuar pranë Qendrës I Sigurt për të marrë shërbime mbështetëse.
- Përpilon plane individuale për fëmijët, në bashkëpunim dhe me stafin e Qendrës I Sigurt dhe bashkëpunëtorë të tjerë si PMF, stafi psikosocial I shkollës, etj.
- Raporton me cilësi dhe në kohë për punën e kryer, duke përdorur instrumentet e standardizuar dhe duke ndjekur protokollet e punës në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve.
- Informon dhe këshillon familjet për shërbimet dhe aktivitetet në qendrën ditore dhe komunitet dhe në nivel bashkie, duke siguruar që ato të marrin mbështetje të integruar dhe të përgjigjen në mënyrë të shpejtë ndaj nevojave të tyre.
- Merr pjesë në takimet e grupit teknik ndërsektorial dhe kontribuon aktivisht në diskutime për çështje të lidhura me mbështetje për fëmijët dhe komunitetin.
- Raporton çdo rast të fëmijëve në vështirësi dhe në nevojë për mbrojtje, duke siguruar që informacioni të dërgohet në kohë pranë koordinatorit të projektit.
- Respekton Kodin e Etikës gjatë punës me fëmijët dhe është i kujdesshëm në trajtimin e materialeve të ndjeshme, duke ruajtur konfidencialitetin dhe duke mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.
- Koordinon dhe siguron mbështetje për individët dhe familjet në nevojë, duke i referuar ata për shërbime të kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror.
- Kryen detyra të tjera sipas planit të aktiviteteve të parashikuara në projekt dhe kontribuon për mbarëvajtjen e tij.
- Respekton afatet dhe kërkesat e vendosura paraprakisht nga stafi drejtues i projektit.
- Merr pjesë në takimet periodike me stafin e projektit dhe sipas kërkesave dhe me stafin e organizatës.

2.2





Funded by
the European Union



2.3 Menaxhimi i detyrës

2.3.1 Organi përgjegjës

Together for Life (TFL) Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil Tekno-Projekt, Hyrja 2,
Ap.14, Tiranë/ Shqipëri

2.3.2 Koha e detyrës

9 muaj duke filluar nga **1 Maj 2025 deri ne 31 Janar 2026**

3. KUALIFIKIME DHE KRITERE PËR PËRZGJEDHJEN

- Diplomë universitare në Psikologji, shkencë sociale ose fusha të tjera të ngjashme, (ose të ketë njohuri shumë të mira të këshillimit, fushës së mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimit të shërbimeve psiko-sociale).
- Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale, shërbimet shoqërore, sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe punës për fuqizimin e fëmijëve, familjeve dhe komunitetit;
- Preferohet të ketë eksperiencë të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile
- Të njohë mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë njohuri të mira në menaxhimin e rasteve të fëmijëve
- Aftësi në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës për fëmijët dhe familjet në nevojë
- Të ketë ndjeshmëri kulturore dhe të mos jetë paragjykes
- Të jetë i aftë për të punuar në grup, por të jetë dhe i pavarur në realizimin e detyrave të përcaktuara
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira analitike dhe planifikuese.
- Aftësi shumë të mira komunikimi, të shkrimit dhe raportimit.
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Office
- I/e gatshëm/e për të udhëtuar/lëvizur në terren;
- Preferohet që të jetë banor në Njësinë Administrative Mamurras ose në Bashkinë Kurbin

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Together for Life janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Together for Life, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.





Funded by
the European Union



4. APLIKIMI

Personat e interesuar duhet të dërgojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email ose me postë edhe dokumentet si më poshtë (në shqip ose në anglisht) :

- një kopje të CV
- një letër interesi

Në subjekt të emailit të shënohet: Aplikim për pozicionin Psikolog, për Qendrën I Sigurt, në Nj.Administrative Mamurras.

Brenda datës 26 Mars 2025 ora 16:00 në adresën e emailit info@togetherforlife.org.al ose me postë në adresën **Together for Life (TFL)** Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil Tekno-Projekt, Hyrja 2, Ap.14, Tiranë/ Shqipëri

Shënim: Vetëm të përzgjedhurit për intervistë do të njoftohen

